

**Rrugëtimi i Fondacionit
Anna Lindh në Shqipëri
2008-2022**

Raport kërkimor



©Instituti Shqiptar i Medias

St. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Shqipëri

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

ëëë.institutemedia.org

Ky studim është mbështetur financiarisht nga Fondacioni Anna Lindh nëpërmjet Global Price Contract për Drejtuesin e Rrjetit. Mendimet, konkluzionet e gjetjeve dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e Fondacionit Anna Lindh.



Parathënie

Remzi Lani, Drejtor Ekzekutiv i Institutit Shqiptar të Medias

Instituti Shqiptar i Medias u emërua nga Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme si Drejtues i Rrjetit të Fondacionit Anna Lindh Shqipëri në fillim të vitit 2020. Ne e pranuar këtë rol duke ditur shumë për vlerat dhe qëllimin mbi të cilin u krijua fillimisht ALF-ja dhe pak në lidhje me rrjetin dhe përgjegjësitë tona si koordinatorë të tij. Gjatë këtyre dy viteve, përpjekjet tona u fokusuan në rigjallërimin e rrjetit shqiptar, i cili prej disa vitesh ka qenë në heshtje.

Rigjallërimi i rrjetit ishte një proces i gjatë dhe i vështirë, pasi besimi i anëtarëve në Rrjetin Kombëtar ishte zbehur duke marrë parasysh periudhën e gjatë të pasivitetit. Pas këtij procesi, ne jemi të inkurajuar të shohim se anëtarë të rinj po bashkohen dhe rrjeti po rritet në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa anëtarët aktualë përpiqen të ndjekin dhe përbushin përgjegjësitë e tyre si anëtarë.

Megjithatë, një nga gjërat me të cilat luftuam ishte mungesa e informacionit dhe të dhënave në lidhje me rrjetin tonë. Si institucion i bazuar në kërkime, ne mbështetemi shumë në evidenca dhe ky hulumtim ishte i domosdoshëm për dy arsye. Së pari, na ndihmon të kuptojmë më mirë rrjetin dhe së dyti, do të shërbejë si një dokument bazë për vitet e ardhshme.

Gjetjet e hulumtimit janë inkurajuese dhe konfirmojnë interesin e anëtarëve të Rrjetit Shqiptar për të qenë kontribues aktivë për promovimin e dialogut ndërkulturor në rajonin Euro-Mesdhetar. Në të njëjtën kohë, theksojnë potencialin e Fondacionit, që mbetet për t'u eksploruar nga Rrjeti shqiptar.

Esmeralda Kashari, Eksperte

Nuk është asnjëherë tepër të theksoj se Fondacioni Anna Lindh ka qenë si një shkollë për mua duke qenë se kam mësuar shumë sa i takon zhvillimit dhe trendeve të fundit më të shoqërive dhe kulturave në rajonin Euro-Mesdhetar.

Kjo ka ardhur si pasojë e aktivizimit tim të drejtpërdrejtë në nismat e ALF-së, por duke shfletuar kërkimet studimore të publikuara në fushën e dialogut kulturor dhe edukimit qytetar ndërkulturor.

Si një nga ekspertët e përfshirë në këtë kërkim, jam e lumtur që munda të komunikoj me anëtarët e rrjetit për të mbledhur mendimet, sugjerimet dhe të njihja nevojat e tyre. Është për t'u vlerësuar fakti që edhe pse nuk kanë qenë përfshirë ose të kenë fituar ndonjë mbështetje financiare nga programet e ALF-së, anëtarët besojnë në potencialin e Fondacionit dhe vlerat që ai promovon.

Për këtë arsye, unë jam e mendimit që Fondacioni duhet të mbështetet më shumë nga qeveria shqiptare dhe e shteteve të tjera anëtare, në mënyrë që më shumë organizata të mund të fuqizojnë kapacitetet në fushat që ALF promovon, por jo vetëm!

Unë jam shumë mirënjohëse që Instituti Shqiptar i Medias më ftoi të isha pjesë e kërkimit, i cili padyshim zgjoi tek unë interesin më të lartë duke qenë se gjithnjë e jap kontributin tim në Shqipëri me passion.

Përmbledhje ekzekutive

Rrjeti kombëtar i Fondacionit Anna Lindh në Shqipëri u krijua në vitin 2008, afërsisht 14 vjet më parë me qëllimin për të kontribuar në promovimin e Dialogut Ndërkulturor në rajonin Euro-Med. Shqipëria ndan identitetin dhe vlerat mesdhetare, të cilat përfshijnë promovimin e paqes, tolerancës dhe dialogut mes kulturave.

Edhe pse Rrjeti në Shqipëri u krijua më shumë se një dekadë më parë, **nuk ka të dhëna të disponueshme ose një dokument të plotë që përshkruan dhe shpjegon rrugëtimin e Rrjetit të Fondacionit Anna Lindh në Shqipëri.** Për të plotësuar këtë boshllëk, u krye ky studim i cili rreket të paraqese rrugëtimin e Rrjetit ALF në Shqipëri nga viti 2008 – 2022.

Ky studim është bërë gjatë periudhës shkurt – mars 2022, dhe raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga 30 pyetësorë dhe 12 intervista të thelluara, duke përfshirë intervistat me z. Besnik Mustafaj ish-ministër i Punëve të Jashtme dhe Drejtuesi i Parë i Rrjetit; Znj. Admira Jorgji, Drejtoreshë për Evropën, në Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme; dhe anëtarë të Rrjetit Shqiptar të Fondacionit Anna Lindh.

Tre janë shtyllat kryesore që hulumton ky hulumtim: **1) ndikimi që ka pasur anëtarësimi në Rrjet tek anëtarët dhe në përgjithësi për promovimin e dialogut ndërkulturor në Shqipëri; 2) Mbështetja e ALF-së në forcimin e kapaciteteve të anëtarëve kryesisht në Dialogun Ndërkulturor; 3) Roli i Fondacionit në forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit në nivel Euro-Mesdhetar.**

Disa nga gjetjet kryesore të këtij hulumtimi nxjerrin në pah se **prania e ALF-së në Shqipëri ka ndikuar në promovimin e Dialogut Ndërkulturor.** Më konkretisht, 20% e anëtarëve të përfshirë në anketë janë shprehur se Rrjeti ALF ka ndikuar shumë, ndërsa 53.3% mendojnë se ka ndikuar disi.

Sa i përket **mbështetjes së anëtarëve për forcimin e kapaciteteve duhet bërë më shumë në këtë drejtim,** pasi aktualisht mungon prania e iniciativave, projekteve dhe programeve. Rreth 60% e organizatave që morën pjesë nuk kanë marrë mbështetje në iniciativat në lidhje me Dialogun Ndërkulturor.

Më shumë **iniciativa që nxisin dhe inkurajojnë partneritetin në nivel Euro-Mesdhetar duhet të marrin jetë.** Anëtarët mendojnë se nuk patën mundësinë të njihen me anëtarët e tjerë të 41 rrjeteve të tjera. **Fondacioni dhe DiR duhet të jenë më të kujdesshëm dhe të organizojnë më shumë aktivitete që u mundësojnë organizatave të njihen me njëra-tjetrën dhe të krijojnë partneritete,** veçanërisht me partnerët jugorë të Mesdheut.

Studimi **thekson** se anëtarët e anketuar ende besojnë në rëndësinë e forcimit të Rrjetit të Fondacionit Anna Lindh në Shqipëri, pasi **gjeneron shumë mundësi të reja, rrit bashkëpunimin dhe promovon dialogun** në të gjithë Mesdheun. Si shtet anëtar, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, **Shqipëria, mund ta nxisë procesin duke përmbushur detyrimet si vend anëtar, si edhe duke marrë më të mirën e Fondacionit për bashkëpunimin rajonal.**

Shkurtime

ALF – Fondacioni Anna Lindh

DiR – Drejtues i Rrjetit

DN – Dialog Ndërkulturor (ICD)

EQN – Edukimi Qytetar Ndwrkulturor (ICE)

UfM – Unioni për Mesdheun

Euro-Med – Euro Mesdhetare

KiE – Këshilli i Evropës

MEPJ – Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
I. Hyrje	7
II. Rishikim literature	8
2.1 <i>Koncepti i Dialogut Ndërkulturor</i>	8
2.2 <i>Nxitja e Dialogut Ndërkulturor për Paqe, Progress dhe Zhvillim Shoqëror</i>	9
2.3 Mekanizmat, insitutucionet dhe platformat bashkëpunuese që nxisin DN në Euro-Mesdhe	11
2.4 Roli dhe përfshirja e Shqipërisë në platformat Euro-Med për Dialogun Ndërkulturor	14
2.5 Dialogu Ndërkulturor në praktikë: Fakte & Shifra nga Shqipëria	17
III. Metodologjia	18
3.1 <i>Qëllimi dhe objektivat</i>	18
3.2 <i>Pjesëmarrësit</i>	18
3.3 <i>Instrumentet e mbledhjes së të dhënave</i>	19
3.4 <i>Procesi i mbledhjes së të dhënave</i>	19
3.5 <i>Analiza e të dhënave</i>	20
3.6 <i>Kufizimet e kërkimit</i>	20
IV. Rezultatet	21
4.1 Informacion i përgjithshëm për pjesëmarrësit	21
4.2 <i>Prania dhe roli i ALF-së për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të rrjetit</i>	22
4.3 <i>ALF dhe nxitja e dialogut ndërkulturor në Shqipëri</i>	26
4.4 <i>ALF si katalizator për bashkëpunimin në nivelin Euro Med</i>	29
V. Përfundime dhe rekomandime	30
VI. Referenca	32
VII. Shtojca	33
7.1 <i>Pyetësor për anëtarët e Rrjetit</i>	33
7.2 <i>Intervistat e thelluara</i>	37
7.3 <i>Lista e anëtarëve që morën pjesë në intervistat e thelluara:</i>	38
7.3 <i>Lista e anëtarëve që morën pjesë në pyetësor</i>	39

I. Hyrje

Rrjeti Kombëtar i Fondacionit Anna Lindh në Shqipëri u krijua në vitin 2008, rreth 14 vjet më pare, me qëllim që të kontribuonte në promovimin e Dialogut Ndërkulturor në rajonin Euro-Med.

Që nga krijimi i tij, Rrjeti ALF në Shqipëri ka pësuar ndryshime që lidhen kryesisht me anëtarët e rrjetit dhe Drejtuesit e Rrjetit (DiR). Drejtuesi i parë i Rrjetit, i emëruar nga Ministria e Punëve të Jashtme ishte *Forumi Shqiptar për Aleancën e Qytetërimeve* (AFALC). Në shkurt 2020, AFALC u zëvendësua si Drejtues i Rrjeti nga Instituti Shqiptar i Medias, i cili u emërua nga Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme për një mandat tre-vjeçar.

Nën koordinimin e të dy DiR-ve, numri i anëtarëve të rrjetit në Shqipëri nga 2008-2022 është zmadhuar dhe zvogëluar në sajë të funksionimit dhe aktivitetit të rrjetit. Megjithatë, një numër i madh i organizatave që kanë qenë anëtarë që nga fillimi, janë ende aktivë dhe kontribues kyç në promovimin e Dialogut Ndërkulturor, ndërkohë që anëtarë të rinj po i bashkohen kësaj nisme.

Bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme¹, Rrjeti në Shqipëri përbëhet nga 61 organizata anëtare që kanë seli në rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Shumica e anëtarëve janë nga rrethi i Tiranës që mbulojnë zonat urbane dhe rurale, të ndjekura nga organizatat me qendër në Durrës, Fier, Gramsh, Shkodër dhe Vlorë që janë gjithashtu me seli në zonat urbane, por shtrijnë aktivitetin e tyre edhe në zonat rurale.

Anëtarët e Rrjetit vijnë nga eksperiencia të ndryshme dhe kanë ekspertizë në sektorë të tillë si; të drejtat e njeriut, artet, demokracia dhe zhvillimi i komunitetit, studimet fetare, barazia gjinore, trashëgimia, media, marrëdhëniet ndërkombëtare/kulturore, kërkimi, të rinjtë dhe arsimit, mjedisi/zhvillimi i qëndrueshëm. **Pikë e fortë e Rrjetit Shqiptar është shumëllojshmëria e anëtarëve, disiplinave, sektorëve dhe fushave të ekspertizës që krijon një strukturë të pasur të aftë për të shkëmbyer praktikat dhe përvojën më të mirë brenda Rrjetit tonë kombëtar dhe me Rrjetet e vendeve të tjera.**

Pavarësisht të dhënave të pakta në lidhje me DiR-të dhe anëtarët e rrjetit, mungonte një dokument që flet dhe shpjegon rrugëtimin e Rrjetit të Fondacionit Anna Lindh në Shqipëri. Ky kërkim u realizua si nevojë për të mund të krijuar në pasqyrë të rrugëtimin të Rrjetit ALF në Shqipëri nga viti 2008 – 2022.

Ky raport kërkimor ofron një rishikim dhe analizë të politikave dhe strategjive që lidhen me dialogun ndërkulturor në Shqipëri dhe paraqet të dhëna të mbledhura nga anëtarët në lidhje me ndikimin, interesin, kontributin dhe pritshmërinë që ata kanë si anëtarë të ALF-së. Përveç kësaj, sugjerimet dhe rekomandimet kryesore janë dhënë për Fondacionin dhe Drejtuesin e Rrjetit, me synimin për të rritur ndikimin e Rrjeteve në promovimin e dialogut ndërkulturor në nivelin Euro-Mesdhetar.

¹ Verifikimi i fundit është bërë në 25 Mars, 2022

II. Rishikim literature

2.1 Koncepti i Dialogut Ndërkulturor

Në zhargonin politik nuk ekziston një konsensus i mirëfilltë sa i takon përdorimit të dialogut ndërkulturor e për pasojë ky term mbetet disi përgjithësues dhe si i tillë mund të interpretohet në mënyra të ndryshme.

Megjithatë, disa organizata/institucione kanë qenë të interesuara të kontribuojnë për të ofruar qartësi në të kuptuarin e konceptit të dialogut ndërkulturor. Këshilli i Evropës (KiE)², një nga organizatat më të mëdha në nivel Evropian, është ndoshta institucioni politik më relevant që përkrah nevojën për dialog ndërmjet kulturave nxitur kjo dhe na zhvillimet e vazhdueshme të shoqërive Evropiane, por jo vetëm.

Më shumë sesa i ndikuar nga migrimi në nivel ndërkombëtar apo pretendimet e minoriteteve etnike, për KiE, njohja e potencialit dhe ndikimet e efekteve ndër-kulturore në një kohë globaliste do të ndihmonte në të kuptuarit më mirë të varësisë mes rajoneve gjeografike dhe përparimeve në lehtësimin e komunikimit, medias dhe informacionit. Përzjerja multi-kulturore është bërë tashmë pjesë e normës së re dhe një numër në rritje njerëzish duhet të mësohen të përshtaten me identitetin shumë-kulturor.

Në raportin e 2020 'Measuring Intercultural Dialogue'³, UNESCO njeh nevojën për qasje inovative për të adresuar të ashtëquajturat 'ndryshime kulturore' në kapacitetet sociale dhe kulturore që ndikojnë efektshmërinë e përgjigjes ndaj sfidave globale siç janë, pabarazitë, populizmi përçarës, ksenofobia, migrimi, zhvendosja dhe ekstremizmi i dhunshëm.

Megjithatë, siç edhe përcaktohet në Rezolutën e Parlamentit Evropian të 16 Janar 2016 "mbi rolin e dialogut ndërkulturor, diversitetit kulturor dhe edukimit në promovimin e vlerave thelbësore Evropiane"⁴ "*kultura nuk është diçka e pandryshueshme, por më shumë ide fluide që përmbledh pika të ndryshme referimi duke përfshirë gjuhën, besimin, kodin e veshjes, ushqimet dhe pijet, dhe punimet artistike dhe artizanale tradicionale*".

Në thelb të kësaj ligjërate shtrihet mundësia për rritjen e vetë-ndërgjegjësimit për të cilin hapi i parë është të kuptuarit e 'tjetrit'. Teori të pranuar ndërkulturore sugjerojnë që ne mësojmë më shumë për veten tonë kur shohim veten tonë të reflektuar tek të tjerët. Të njohurit e tjetrit është i rëndësishëm për vetëbesimin si dhe për zhvillimin e aftësive shoqërore të cilat në tërësi mund të ndihmojnë në procesin e integritit si edhe përgatitjen e individëve për qytetari aktive. Për më shumë, *një dialog ndërkulturor më kuptimplotë kërkon njohuri të mira të individit për kulturën e vetë dhe kulturave të tjera*⁵.

² https://www.coe.int/t/dg4/intercultural/concept_EN.asp#P12_1420

³ Measuring Intercultural Dialogue - A Conceptual and Technical Framework, published in 2020 by the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), 7, place de Fontenoy, 75352 Paris 07 SP, France and the Institute for Economics and Peace, 205 Pacific Highway, St Leonards, Sydney, 2065 NSW, Australia <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373442.locale=en>

⁴ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

⁵ idem

Çfarë është kultura?

Kultura përbëhet nga tipare dhe njohuri të një grupi të caktuar njerëzish dhe përfshin gjuhën, besimin fetar, gastronominë, zakonet kulturore, muzikën dhe artin.

Kultura përmban modele të përbashkëta sjelljesh dhe ndërveprimesh, modele konjitive dhe perceptime që janë të mësuara nga shoqërizimi. Kështu, mund të shihet si nxitëse e identitetit të një grupi e shtyrë dhe nga modelet shoqërore të këtij grupi.

Për Këshillin e Evropës, qëllimi i përgjithshëm i dialogut ndërkulturor është të mësuarit e të jetuarit së bashku në mënyrë paqësore dhe konstruktive në një botë multikulturore dhe të zhvillojë ndjenjën e komunitetit dhe përkatësisë. Për më tepër, dialogu ndërkulturor mund të jetë gjithashtu një mjet për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve duke rritur respektin për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.”⁶

Në përpjekje për të vënë në qendër të dialogut ndërkulturor nevojën për të komunikuar dhe ndërvepruar ndërmjet përfaqësuesve të kulturave të ndryshme, KiE ka ardhur me këtë përkufizim:

“Dialogu ndërkulturor është një shkëmbim i hapur dhe i respektueshëm i pikëpamjeve ndërmjet individëve dhe grupeve që u përkasin kulturave të ndryshme që çon në një kuptim më të thellë të perceptimit global të tjetrit”.

(CoE, White Paper on Intercultural Dialogue)⁷

Për sa i përket BE-së, Rezoluta e Parlamentit⁸ e datës 19 janar 2016, “inkurajon të gjitha palët e interesuara të krijojnë një përkufizim të përditësuar, të qartë dhe të lidhur me politikat e dialogut ndërkulturor, për të zbatuar ose harmonizuar metodat, kriteret e cilësisë dhe treguesit me qëllim vlerësimin e ndikimit të programeve dhe projekteve të dialogut ndërkulturor, dhe për metodologjitë e kërkimit për krahasimet ndërkulturore”.

2.2 Nxitja e Dialogut Ndërkulturor për Paqe, Progress dhe Zhvillim Shoqëror

Dialogu mes kulturave nuk është një koncept i ri. Historikisht është vërtetuar të ketë shërbyer si një urë lidhëse midis palëve në konflikt duke sjellë si rezultat përfundimtar paqen dhe zhvillimin e ndërsjellë. Kur Dialogu Ndërkulturor zhvillohet në lidhje me indikatorë të tjerë, ai përfaqëson potencial të rëndësishëm për të zhvilluar shoqëritë.

⁶ https://www.coe.int/t/dg4/intercultural/concept_EN.asp#P12_1420

⁷ https://www.coe.int/t/dg4/intercultural/whitepaper_EN.asp#TopOfPage

⁸ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

Për UNESCO-n⁹ është gjithnjë e më e qarte se sukcesi i sistemeve tona të qeverisjes, shkollave dhe ekonomisë varet nga shfrytëzimi dhe maksimizimi i përfitimeve nga diversiteti në rritje i prejardhjeve dhe perspektivave në shoqëri, si dhe nga përmirësimi i komunikimit ndërmjet tyre.

“(Dialogu Ndërkulturor) – një emërtim i gjerë për shumë forma komunikimi, shkëmbimi dhe ndërveprimi që lehtësojnë të mësuarit dhe ndryshimin transformues përtej kufijve realë dhe të perceptuar ndërmjet grupeve dhe individëve të ‘kulturave’ ose identiteteve të ndryshme – është përdorur më pak si një qasje deri më tani. Kjo për shkak se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme në lidhje me efektivitetin e saj për krijimin e shoqërive më paqësore, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme dhe nuk kuptohen mjaftueshëm për kushtet që mundësojnë suksesin e saj”.

(Measuring Intercultural Dialogue, UNESCO, 2020)¹⁰

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, disa vende evropiane, veçanërisht Gjermania dhe shoqëritë skandinave, kanë mbështetur një besim se shkëmbimet ndërkulturore të mirëmenaxhuara dhe të ndërmjetësuara përgjithësisht janë pranuar për të prodhuar përfitime ekonomike dhe sociale, si dhe kanë potencial të prekshëm për zgjidhje politike për konflikti. Vitet e fundit, këto besime janë përfshirë më tej në kuadrin e punës së Parlamentit Evropian¹¹, i cili thekson se duhet pranuar se popujt migrues sjellin me vete aftësi, njohuri, ide, qasje të reja, sipërmarrje dhe praktika kulturore që pasurojnë strukturën sociale të komuniteteve që ata të bëhen pjesë e, dhe se migrimi është pjesë e trashëgimisë sonë kulturore.

Prandaj, ndërsa një rritje e shpejtë e përzierjes kulturore shoqërohet në mënyrë të pashmangshme me sfidat shoqërore dhe politike të cilat nuk përjashtojnë episodet e jo-tolerancës, urrejtjes, diskriminimit dhe racizmit, adresimi i tyre fillon duke njohur dhe diskutuar ekzistencën e tyre dhe potencialin për të kërcënuar paqen dhe bashkëjetesën ndërmjet kulturave.

Disa autorë pohojnë se veprimet dhe promovimi aktiv i dialogut ndërkulturor dhe multikulturalizmit nuk mjaftojnë për të pasur sukses. Stokke dhe Lybaek¹² argumentojnë se ndërsa multikulturalizmi i shtetit liberal rrezikon të esencializojë grupet e pakicave, dialogu ndërkulturor duhet të kombinohet me multikulturalizmin kritik, i cili, si lëvizje shoqërore, i referohet betejave të pakicave për t'u njohur si të barabartë në raport me shumicën.

Për Bashkimin Evropian¹³, adresimi i sfidave të multikulturalizmit kërkon që dialogu kulturor dhe diversiteti të integrohen në mënyrë të tërthortë në të gjitha fushat e politikave sociale si

⁹ Measuring Intercultural Dialogue - A Conceptual and Technical Framework, published in 2020 by the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), 7, place de Fontenoy, 75352 Paris 07 SP, France and the Institute for Economics and Peace, 205 Pacific Highway, St Leonards, Sydney, 2065 NSW, Australia <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373442.locale=en>

¹⁰ idem

¹¹ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

¹² Stokke, Christian, and Lena Lybaek. “Combining Intercultural Dialogue and Critical Multiculturalism.” *Ethnicities*, vol. 18, no. 1, [Sage Publications, Inc., Sage Publications, Ltd.], 2018, pp. 70–85, <https://www.jstor.org/stable/26413998>.

¹³ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

ato për fëmijët dhe të rinjtë, arsimi, lëvizshmëria, punësimi dhe çështjet sociale, siguria dhe çështjet e brendshme, të drejtat e grave dhe barazinë gjinore dhe zhvillimin rajonal.

Sipas një organizate tjetër, Organic Strategies¹⁴ duke qenë se kultura e dialogut mundëson rrjedhjen e lirë të informacionit, të jetuarit e një kulturë dialogu do të thotë të ndërtosh themele të reja të një komunikimi të integruar dhe aktivizimi i potencialit të vërtetë krijues.

2.3 Mekanizmat, insitucionet dhe platformat bashkëpunuese që nxisin DN në Euro-Mesdhe

2.3.1 Rishikimi i Politikës Evropiane të Fqinjësisë dhe Rezoluta e Parlamentit Evropian “mbi rolin e dialogut ndërkulturor, diversitetit kulturor dhe arsimit në promovimin e vlerave themelore të BE-së”

Publikimi i rishikimit të Politikës Evropiane të Fqinjësisë në 2015 theksoi përparimin e bërë në bashkëpunimin rajonal. Nëpërmjet kësaj politike, BE-ja u ofron fqinjëve të saj një marrëdhënie të privilegjuar, duke u mbështetur në një zotim të ndërsjellë ndaj vlerave të përbashkëta (demokracia dhe të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, parimet e ekonomisë së tregut dhe zhvillimi i qëndrueshëm).

Në rezolutën e 19 janarit 2016, pas Rishikimit të Politikave Evropiane të Fqinjësisë, Parlamenti Evropian¹⁵ thekson se “...ndërsa nene të veçanta të Deklarata e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian janë të një rëndësie të veçantë për dialogun ndërkulturor duke promovuar barazinë, mosdiskriminimin, diversiteti kulturor, fetar dhe gjuhësor, liria e shprehjes dhe lëvizjes, e drejta e qytetarisë për pjesëmarrje ekonomike dhe politike...”, ende ekziston nevoja për “një bashkëpunim më të madh dhe më koherent ndërmjet strukturave të ndryshme të politikave dhe fushave të ndryshme, jo vetëm në nivel të evropian, por edhe në nivel kombëtar dhe vendor”.

Ndërsa pranohet se *dialogu ndërkulturor është një mjet për pjesëmarrjen demokratike gjithëpërfshirëse dhe fuqizimin e qytetarëve*, rezoluta argumenton më tej se si i tillë, *dialogu ndërkulturor mund të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e demokracisë dhe zgjerimin dhe thellimin e përfshirjes dhe ndjenjës së përkatësisë.*

Rezoluta bën gjithashtu një apel që *dialogu ndërfaqësor të konsiderohet si një komponent i dialogut ndërkulturor dhe, si i tillë, një parakusht për paqen dhe një mjet thelbësor i menaxhimit të konfliktit, duke u fokusuar në dinjitetin e individit dhe në nevojën për të mbështetur të drejtat e njeriut në mbarë botën, me vëmendje të veçantë për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe të drejtën e mbrojtjes së pakicave fetare.*

Në një pikë tjetër të rëndësishme Rezoluta e Parlamentit Evropian njej, ndër të tjera, rolin kyç që OJQ-ve, rrjetet dhe platformat kulturore që duhet të vazhdojnë të luajnë aty ku strukturat, politikat ose programet formale të dialogut ndërkulturor janë më pak të zhvilluara.

¹⁴ <https://organicstrategies.de/en/culture-of-dialogue/>

¹⁵ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

Këshilli i Europës

Nëse bëjmë një retrospektivë të shpejtë aktiviteteve të organizuar nga Këshilli i Evropës në të shkuarën si dhe ato të së tashmes, vihet re se ato mbulojnë fusha të tilla si arsimi, kultura, sporti dhe rinia duke patur si fokus kryesor nxitjen e dialogut ndërkulturor si një mjet për të luftuar racizmin dhe ksenofobinë, mirëkuptimin reciprok dhe vlerat si toleranca, respekti për të tjerët dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri. KiE ka një traditë të pasur në transferimin e njohurive mbi dialogun kulturor në praktika dhe burime konkrete siç është Përmbledhja e Politikave dhe Trendeve Kulturore (Compendium of Cultural Policies and Trends)¹⁶. Kjo traditë e pasur vjen si pasojë e një sërë nismash dhe aktiviteteve të organizuara ndër vite në shtetet anëtare të KiE.

Procesi i Barcelonës dhe Procesi i Partneritetit Euro-Mesdhetar

Është e gjerësisht e pranuar se rajoni i Mesdheut ka kontribuar masivisht në promovimin e bashkëjetesës së kulturave dhe besimeve fetare përgjatë historisë. Ndërmjet brigjeve veriore dhe jugore të Mesdheut, komunitetet dhe kulturat gjithmonë kanë shkëmbyer ide dhe njohuri si edhe bërë tregti.

Më 28 nëntor 1995 Ministrat e Punëve të Jashtme të BE-së dhe 12 vendeve të Mesdheut jugor dhe lindor mbajtën konferencën e parë Euro-Mesdhetare në Barcelonë dhe nënshkruan një marrëveshje për të nisur Procesin e Partneritetit Euro-Mesdhetar. Procesi i Barcelonës (Barcelona Process)¹⁷ lindi si një kornizë e re dialogu nga një thirrje për të transformuar rajonin e Mesdheut në një hapësirë të përbashkët ku mbizotëron paqja, stabiliteti, siguria dhe përparimi i përbashkët socio-ekonomik dhe dialogu midis popujve.

Qëllimi i Procesit të Barcelonës ishte forcimi i marrëdhënieve midis Evropës dhe vendeve të Mesdheut Jugor. Kjo shprehje e mirëbesimit dhe pranimi se lidhjet më të ngushta ishin në interesin e të gjithëve do të çonte më vonë në krijimin e Fondacionit Anna Lindh (ALF) dhe të Unionit për Mesdheun (UfM).

Fondacioni Anna Lindh (ALF)

Fondacioni Anna Lindh u krijua në 2004 pas një sërë ngjarjesh globale të fillimit të shekullit të 21-të që rrezikuan të nxisnin polarizimin midis shoqërive në rajonin e Mesdheut. ALF ishte institucioni i parë i përbashkët me fokus dialogun, i bashkëkrijuar nga Bashkimi Evropian dhe vendet partnere mesdhetare. ALF u krijua me nismën politike të Presidentit të atëhershëm të Komisionit Evropian Romano Prodi, "ndërmarrjen e veprimeve për të rifilluar dialogun dhe për të zbutur rrezikun e një përplasjeje qytetërimesh". Selia e ALF është në Aleksandri, Egjipt.

Fillimisht i quajtur "Fondacioni Euro-Mesdhetar për Dialogun midis Kulturave", Fondacionit iu dha emri i Ministres së Jashtme suedeze Anna Lindh, e cila u vra në vitin 2003 në një akt të krimin të urrejtjes; Angazhimi i përhershëm i Anës ishte për partneritet të barabartë midis

¹⁶ <https://www.culturalpolicies.net/>

¹⁷ <https://ufmsecretariat.org/25bcnprocess/>

Veriut dhe Jugut, si edhe ndaj veprimit të partneritetit shumëpalësh, të cilat u bënë më pas parim udhëzues për punën e ALF-së¹⁸ Gjatë dhjetëvjeçarit të parë, ALF ka ndërtuar rrjetin më të madh Jug/Veri mbi dialogun mesdhetar, duke përfshirë drejtpërdrejt mijëra drejtues të rinj, gra sipërmarrëse, edukatorë, artistë, gazetarë, studiues, kryetarë bashkie dhe politikëbërës vendor.

Objektivat kryesore të ALF-së përfshijnë promovimin e ndërgjegjësimit kulturor, dijes dhe kompetencave midis shoqërive euro-mesdhetare; adresimi i intolerancës dhe stereotipeve nëpërmjet promovimit të debateve, komunikimit publik dhe nismave në nivel vendor; ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile duke nxitur partneritet, shkëmbimet dhe bashkëpunimet trans-mesdhetare; duke punuar me vendimmarrësit dhe mediat për të forcuar marrëdhëniet kulturore dhe për t'i mbajtur ato në qendër të axhendës së dialogut mesdhetar.

Një nga burimet më të rëndësishme të ALF-së për dialogun ndërkulturor janë “The Anna Lindh Education Handbook: Intercultural Citizenship in the Euro Mediterranean Region”¹⁹ dhe projekti “Young Mediterranean Voices”²⁰

Unioni për Mesdheun -Union for the Mediterranean (UfM)

Unioni për Mesdheun (UfM) është një organizatë ndërqeveritare Euro-Mesdhetare e cila bashkon të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe 15 vende të Mesdheut Jugor dhe Lindor. Misioni i Unionit është të rrisë bashkëpunimin në nivel rajonal, dialogun dhe zbatimin e projekteve dhe nismave me ndikim të prekshëm tek qytetarët, duke vënë theksin tek të rinjtë dhe gratë, duke adresuar kështu tre objektivat strategjikë të rajonit: stabilitetin, zhvillimin njerëzor dhe integrimin.

Një nga qëllimet e krijimit të këtij institucioni ishte mbështetja e krijimit dhe zhvillimit të rajonit Euro-Mesdhetar. Megjithatë, shumë kritikë e konsiderojnë këmbënguljen e UfM-së në të fokusuarit në bashkëpunimin me aktorë privatë dhe kryesisht përmes bashkëpunimit teknik, si një qasje neo- funksionaliste dhe tejet teknokratik dhe rrjedhimisht jo shumë politik. Megjithatë, në konferencën e Marsejës, përfaqësia politike Evropiane donte që çështjet që do të trajtoheshin nga UfM të mos kufizoheshin vetëm në ato ekonomike.

Forcimi i dy qendrave kryesore rajonale për arsimin e lartë Euro-Mesdhetar

Në dhjetor 2014 u hap Universiteti Euro-Mesdhetar i Fez-it (EMUF). EMUF ishte miratuar më parë si qendër e arsimit të lartë nga Shtetet Anëtare të UfM-së në vitin 2012 dhe më herët Universiteti UNIMED u përrua në 2008 në Piran, Slloveni. Universiteti EMUF tani funksionon si një qendër rajonale e përsosmërisë me një eko-kampus unik në rajon. Universiteti UNIMED²¹ ofron një rrjet të gjerë prej mbi 130 universitetesh nga mbi 30 vende euro-mesdhetare.

¹⁸ <https://www.annalindhfoundation.org/our-story>

¹⁹ https://www.annalindhfoundation.org/sites/annalindh.org/files/documents/page/education_handbook_pages_2_-_3_-_2017.pdf and <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/anna-lindh-education-handbook-intercultural-citizenship-euro>

²⁰ <https://www.britishcouncil.jo/en/programmes/society/young-mediterranean-voices>

²¹ <https://www.uni-med.net/>

2.4 Roli dhe përfshirja e Shqipërisë në platformat Euro-Med për Dialogun Ndërkulturor

Sipas Besnik Mustafaj²², interesi i Shqipërisë për t'u angazhuar në platforma që promovojnë dialogun ndërkulturor dhe bashkëpunimin, i krijuar nën kornizën e Procesit të Barcelonës dhe Procesi i Partneritetit Euro-Mesdhetar daton që prej 2005.

“Kur sapo isha emëruar ministër i Jashtëm i Shqipërisë, në vitin 2005, duke qenë se kisha njohuri të mira sa i takon historisë së përbashkët të rajonit të Mesdheut dhe ndikimin reciprok në të dy brigjet e detit Mesdhe, isha i interesuar të shihja Shqipërinë duke u bërë anëtare, si në Fondacionin Anna Lindh ashtu edhe në Unionin për Mesdheun që u krijua më vonë (në 2008). Unë kam qenë veçanërisht i këmbëngulës për të bindur qeverinë shqiptare të asaj kohe që vendi të anëtarësohej në UfM. Më vonë, kur nuk isha më në politikë, isha kryetar i një OJQ-je, e cila u propozua si Drejtues i Rrjetit të ALF-së në Shqipëri”.

(Intervistë me Besnik Mustafaj, Shkurt 2022)

Megjithatë, pavarësisht nga qasja e Z. Mustafaj për lidhjet e forta të Shqipërisë, historinë e përbashkët dhe të kaluarën dhe të tashmen e përbashkët me kulturat evropiane dhe mesdhetare, roli i Shqipërisë në çështjet e Mesdheut shpesh shihej me skepticizëm nga nivelet e larta të zyrtarëve të qeverisë shqiptare. Sipas Mustafaj, *“ekzistonte një frikë naive e të krijuarit një përshtypje se Shqipëria po devijonte nga rruga e saj e integritimit në BE dhe po shkonte drejt Lindjes dhe se, nga njëra anë, kjo mund të përdorej për përfitime politike nga kundërshtarët politikë – siç ishte rasti kur Shqipëria iu bashkua më parë Konferencës Islamike – dhe, nga ana tjetër, se synimet e Shqipërisë mund të keqinterpretoheshin nga partnerët evropianë”²³.*

Në kuadër të nismës së FALF-së ‘Restore Trust, Rebuild Bridges, Rrjeti Shqiptar u përfshi në nisjen e ‘Play for Peace’, e cila mbledhi së bashku fëmijë dhe adoleshentë nga disa shkolla të Tiranës; projekti përfshiu pjesëmarrës të rinj në aktivitete sportive, kulturore dhe argëtuese, si një mënyrë për të nxitur dialogun midis të rinjve nga grupe të ndryshme të marginalizuara, si romët, fëmijët jetimë dhe përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme fetare.

Anëtarët e Rrjetit Shqiptar nisën gjithashtu një sërë nismash kombëtare me mbështetjen e rrjetit ALF, duke përfshirë: botimin me titull ‘Gratë dhe Feja’ mbi rolin e gruas në tre komunitetet kryesore fetare dhe në jetën socio-politike, dhe ‘Cultures Talk’, një forum i hapur dhe fushatë.

Nisma ‘Forumi i Hapur’ (Open Forum) (2014) hulumtoi çështje të identitetit kulturor të emigrantëve shqiptarë në vendet e Euro-Mesdhetare. Në vitin 2012, anëtarët u përfshinë në “Mediterranean Network: Step One Lampedusa”, i cili përfshinte kërkime mbi çështjet e emigrantëve shqiptarë në Itali.

Në të njëjtin vit, takimi rajonal i ALF-së me temë “Perspektivat e bashkëjetesës ndërfaqetare” (Prospects for Inter-Religious Coexistence’), i inauguruar zyrtarisht nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, u bashkë-organizua nga Drejtuesi i Rrjetit në Tiranë. Anëtarët e Rrjetit Shqiptar kanë lançuar gjithashtu botimin e titulluar “Gratë dhe Feja” (Women and Religion) mbi rolin e gruas në tre komunitetet kryesore fetare dhe në jetën socio-politike, së bashku me fushatën “Cultures Talk”. Rrjeti Shqiptar ishte pjesë e “Kimiyya, Gratë Aktore të Dialogut” (2017) konferenca ndër-rrjetore që mbledhi 150 përfaqësues nga 12 Rrjetet Kombëtare të ALF-së.

The Anna Lindh Review 2005-2011 and the Anna Lindh Foundation 15-Year Review 2005-2020²⁴

²² Former Minister of Foreign Affairs of Albania (2005-2007) and President of the Albanian Forum for the Alliance of Civilizations (AFALC), the Head of the Albanian ALF Network and Albanian member of the ALF Advisory council (2008-2011)

²³ Interview with Besnik Mustafaj at the Albanian Media Institute in Tirana, Albania, February 2022.

²⁴ Excerpts from the Anna Lindh Review 2005-2011 and the Anna Lindh Foundation 15-Year Review 2005-2020

Që prej vitit 2020, Rrjeti Shqiptar i ALF-së koordinohet nga Instituti Shqiptar i Medias (AMI). Përgjatë kësaj kohe, fokusi ka qenë mbi dialogun ndërkulturor në fushat e të drejtave të njeriut, medias, studimeve kërkimore, diversitetit dhe arsimit.

Që nga fillimi i mandatit të saj si DiR, përpjekjet e AMI-t kanë qenë në rivitalizimin dhe riaktivizimin e Rrjetit, i cili ka qëndruar i heshtur për disa vjet, duke rezultuar në 45 anëtarë aktivë të ardhur nga prejardhje të ndryshme gjatë vitit 2020; 30 anëtarë kanë seli në qarkun e Tiranës (duke përfshirë aktivitete si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale) dhe 15 janë me qendër në rrethin e Durrësit, Shkodrës, Fierit, Pogradecit dhe Vlorës. Të gjithë anëtarët kanë ekspertizë dhe mbulojnë në sektorë të ndryshëm.

Sipas Admiras Jorgji²⁵, drejtoreshë e departamentit të BE-së në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), e cila përkrah përgjegjësitë të tjera që ka, mbikëqyr edhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në nismat Euro-Mesdhetare duke theksuar se Shqipëria i kushton vëmendje kësaj çështjeje. Kjo edhe për shkak të historisë së veçantë tashmë të njohur të vendit lidhur me shpëtimin dhe strehim të të gjithë hebrenjve që kalonin tranzit nëpër Shqipërinë e pushtuar nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke i shpëtuar Holokaustit. Pavarësisht se shqiptarët identifikoheshin në masë të madhe me besimin mysliman, asnjë hebre nuk iu dorëzua pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre vendas. *“Ende nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme temës që nga Lufta e Dytë Botërore”,* pranon Jorgji. *“Pjesëmarrja aktive në UfM dhe ALF mund të jetë një mënyrë për të ndërtuar imazhin mbi praktikën tona të mira në histori dhe për t'i ndarë ato me vendet e tjera anëtare”.*

Interesat e Shqipërisë kanë të bëjnë kryesisht me bashkëpunimin (mesdhetar) për bashkëpunimin ekonomik dhe energjitik, dhe më pak (fushën e) dialogut ndërkulturor. Por, sigurisht, ne jemi të interesuar të prezantojmë praktikën e mira të Shqipërisë tek homologët tanë mesdhetarë. Pas efekteve të shkaktuara nga lufta në Siri, veçanërisht në lidhje me krizën e refugjatëve sirianë, interesi ynë po ripërtërihet”.

(Admira Jorgji, Drejtoreshë e Departamentit të BE-së në MEPJ të Shqipërisë, 2022)

Ndonëse nuk është një koncept rreptësisht ligjor, dialogu ndërkulturor nuk rregullohet nga ligjet specifike në nivel kombëtar, të BE-së apo ndërkombëtare. Megjithatë, ai është ndërtuar mbi kornizat ndërkombëtare që synojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe diversitetit kulturor. Sipas Rezolutës së Parlamentit Evropian të datës 19 janar 2016 “mbi rolin e dialogut ndërkulturor, diversitetit kulturor dhe edukimit në promovimin e vlerave themelore të BE-së”²⁶ *“Në kontekstin e dialogut ndërkulturor, zbatimi i të drejtave universale të njeriut (si të drejta individuale) dhe i të drejtave kulturore (duke njohur identitete specifike dhe të shumëfishta kulturore) janë thelbësore”.*

²⁵ Director of EU Department at the Ministry for Europe and Foreign Affairs of Albania (2022)

²⁶ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

E njëjta Rezolutë, “i bën thirrje Komisionit dhe Këshillit të miratojnë dialogun ndërkulturor si një objekt politik të fortë dhe të përkushtuar të BE-së dhe për këtë arsye të garantojnë mbështetjen e BE-së përmes masave të ndryshme politike, nismave dhe fondeve, duke përfshirë dialogun ndërkulturor me vendet e botës së tretë, veçanërisht shtetet e brishta.”

Deri së fundi, siç dhe z. Mustafaj si president i ish-Drejtesit të Rrjetit Shqiptar të ALF-së pranoi, angazhimi i rrjetit shqiptar të Fondacionit Anna Lindh duket se ka qenë më pak i fokusuar në transmetimin e mesazheve thelbësore dhe zhvillimin e aftësive kyçe të nevojshme për një dialog ndërkulturor të efektshëm, por më tepër mbi Fondacionin si një burim financimi për nisma individuale e anëtarëve të rrjetit. Sipas tij, kjo është pjesërisht për shkak se bashkëpunimi Veri-Jug nuk është mjaft i qëndrueshëm dhe motivues.

“Ndonjëherë, anëtarë individualë ose OJQ individuale brenda ose jashtë rrjetit shqiptar do të përfitonin drejtpërdrejt nga grantet e ALF-së pa u filtruar paraprakisht nga HoN-i shqiptar”, tregon Mustafaj. Sipas tij, kjo nuk është e drejtë pasi dobëson autoritetin e organizatës që është Drejtues Rrjeti.

Në të njëjtën kohë, ai pranon gjithashtu se angazhimi i ish-Drejtesit të Rrjetit - që ai drejtonte, por që nuk është më aktive - me anëtarët e rrjetit shqiptar ka qenë i kufizuar. “Shumica e përfshirjes ka qenë për kryerjen e disa trajnimeve dhe kryerjen e disa sesioneve për shkëmbim informacioni”. Vetëm herë pas here ata (AFALC) do të ndihmonin rrjetin duke organizuar trajnime lidhur me shkrimin e projekt-propozimeve, i cili duket se ka qenë thelbësor për t'u përfshirë në skemat e granteve të ALF-së dhe për të nxitur partneritetin.

Angazhimi i qeverisë së shqiptare me ALF-në ka qenë edhe më pak efektiv. Qeveria ndaloi së ofruari kontributin e saj financiar për Fondacionin rreth një dekadë më parë. Në mbledhjet statutorë të ALF-së nuk morën pjesë as përfaqësuesit e MEPJ-s.

“Aktualisht, angazhimi në këtë kontekst (mesdhetar) është përgjegjësi e Departamentit për Evropën në MEPJ. ¿Por a duhet të jetë kështu?”, mendon Jorgji. “Megjithatë, kohët e fundit është diskutuar një zhvendosje e brendshme e përgjegjësive. Ende nuk është e qartë se si do të ricaktohen”, tregon ajo. Më pas thekson se: “Megjithatë, në kuadrin e përgjithshëm të trajtimit të çështjeve të Mesdheut, ajo që mbetet prioritet është angazhimi me UfM-në”.

Rezoluta e Parlamentit të BE-së e datës 19 janar 2016 “mbi rolin e dialogut ndërkulturor, diversitetit kulturor dhe edukimit në promovimin e vlerave themelore të BE-së²⁷”, i bën thirrje Komisionit dhe Shteteve Anëtare të zhvillojnë strategji që **njohin dialogun ndërkulturor si një proces komunikimi ndërveprues brenda dhe ndërmjet kulturave, për të siguruar respekt të ndërsjellë dhe mundësi të barabarta, për të ofruar dhe zbatuar zgjidhje efektive për të trajtuar pabarazitë ekonomike dhe sociale dhe shkaqet e përjashtimit, si dhe të gjitha format e diskriminimit dhe për të zhvilluar një kuptim më të thellë të perspektivave dhe praktikave të ndryshme**; rikujton rolin kryesor të luajtur nga media, përfshirë mediat sociale, si një platformë e mundshme për fjalimet me përmbajtje ekstremizmi dhe si një mjet për të luftuar narrativat ksenofobike, për të thyer stereotipet dhe paragjykimet dhe për të promovuar tolerancën.

²⁷ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0005_EN.html

2.5 Dialogu Ndërkulturor në praktikë: Fakte & Shifra nga Shqipëria

Në Rrjetin Shqiptar janë përfshirë në fillim 25 organizata të shoqërisë civile ndërsa aktualisht numri është rritur në 61

13 projekte të reja të mobilizuara nga FSHF përmes fushatës '1001 Veprime për Dialog'

45 pjesëmarrës nga 21 vende u mbledhën në një nga takimet përgatitore të Forumit Anna Lindh në Tiranë, të inauguruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

250 fëmijë dhe adoleshentë nga disa shkolla të Tiranës u mbledhën gjatë projektit 'Luaj për Paqen' në kuadër të iniciativës së ALF Restore Trust, Rebuild Bridges.

7 organizata të shoqërisë civile shqiptare të përfaqësuara në Forumin Anna Lindh 2010 në Barcelonë

Besnik Mustafaj është anëtar i Këshillit Këshillimor të Fondacionit Anna Lindh për periudhën 2008 – 2011

Instituti Shqiptar i Medias u emërua Drejtues i Rrjetit të rrjetit ALF në shkurt 2020

Takimi i fundit i rrjetit kombëtar u mbajt më 22 Janar 2021 dhe morën pjesë 22 anëtarë të Rrjetit.

2 Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve u organizuan gjatë vitit 2021 për anëtarët e rrjetit në temat e DN dhe Menaxhimit të Projekteve

Më 30 Maj 2021 u organizua një shkëmbim i përbashkët kulturor online me të rinjtë shqiptarë dhe letonezë.

Albanian HoN (AMI) zbatoi në një projekt afatshkurtër në bashkëpunim me partnerë nga Spanja (AIFED) dhe Tunizia (WEYouth) me titull "Mind the language" në kuadër të Programit të Intercultural Cities and Learning.

"Udhëtimi i lire" (anëtar i rrjetit) ishte drejtuesi i projektit "Invisible forewomen" në partneritet me Slloveninë, Jordaninë, Turqinë dhe Egjiptin.

4 të rinj morën pjesë në konkursin letrar "Deti i fjalëve" gjatë vitit 2021

1 përfaqësues i rrjetit (Youth Voice Organizations) mori pjesë në ToT mbi Edukimin Qytetar Ndërkulturor të organizuar nga ALF.

2 të rinj të talentuar nga Shqipëria morën pjesë në ekspozitën e artit "The Gap" të organizuar nga Rrjeti Austriak i FSHF-së dhe punimet e tyre u publikuan online.

Dhjetëra anëtarë kanë marrë pjesë në trajnimet online të organizuara nga ALF, apo rrjete të tjera.

III. Metodologjia

3.1 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij kërkimi është të hedhë dritë dhe të japë një përshkrim të plotë të rrugëtimit të Rrjetit ALF në Shqipëri, që nga krijimi i Rrjetit në vitin 2008 e deri së fundmi (2022), duke u fokusuar në ndikimin e pranisë së ALF-së në promovimin e dialogut ndërkulturor në përgjithësi dhe roli i Fondacionit në rritjen e kapaciteteve të rrjeteve kombëtare dhe bashkëpunimit në nivelin Euro-Med.

Objektivat e këtij hulumtimi janë konceptuar tërësisht për të mbuluar të gjithë komponentët e qëllimit kryesor.

Në këtë drejtim, objektivat janë:

- Të ofrojë një rishikim të përgjithshëm të politikave dhe strategjive për promovimin e DN
- Të analizoje interesat dhe pritshmëritë e anëtarëve nga Rrjeti i ALF-së;
- Të reflektojë për kontributet dhe përfitimet e anëtarëve nga rrjeti i ALF-së;
- Të identifikojë ndërgjegjësimin dhe njohuritë e anëtarëve mbi DN;
- Të diskutohet ndikimi që Rrjeti ALF ka pasur në perceptimet e anëtarëve për DN
- Të eksplorohet bashkëpunimi i anëtarëve në nivel kombëtar dhe Euro-Med;
- Të elaborohet perspektiva e anëtarëve në lidhje me statusin e anëtarësimit të tyre në të ardhmen.

3.2 Pjesëmarrësit

Ky kërkim synoi fillimisht anëtarët e rrjetit në Shqipëri, të cilët kontribuan duke plotësuar pyetësonin online (30) dhe duke marrë pjesë në intervista të thelluara (10). Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 31 anëtarë të rrjetit, që në bazë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve përbën 50%, dhe kjo është një shkallë e kënaqshme duke marrë parasysh nivelin e angazhimit të anëtarëve në Rrjet.

Krahas anëtarëve të rrjetit, intervista të thelluara u zhvilluan me z. Besnik Mustafaj dhe znj. Admira Jorgji, Drejtoreshë për Evropën në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Në total, **30 pjesëmarrës morën pjesë në këtë studim duke plotësuar pyetësonin dhe 12 të tjerë kontribuan në intervista të thelluara.**

3.3 Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

Për qëllimin e hulumtimit, u zhvilluan dy instrumente për mbledhjen e të dhënave nga ekspertët në bashkëpunim me DiR. Instrumenti i parë ishte pyetësi për anëtarët e Rrjetit, projektuar dhe shpërndarë online nëpërmjet e-mail dhe mediave sociale, ndërsa e dyta ishte intervista gjysmë e strukturuar për intervistat e thelluara.

Pyetësi përmbante 33 pyetje të organizuara në katër seksione. Seksioni i parë kishte pyetje që grumbullonin informacione të përgjithshme për anëtarët (viti i anëtarësimit në fondacion, fusha kryesore e veprimit, etj). Seksioni i dytë përmbante pyetje që mblodhën informacion mbi ndikimin e Rrjetit ALF për promovimin e ICD në Shqipëri. Seksioni i tretë nga ana tjetër kishte pyetje në lidhje me mbështetjen dhe zgjerimin e anëtarëve të rrjetit, ndërsa pjesa e katërt ishte mbledhja e informacionit mbi rolin e ALF-së në forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërrajonal.

Të gjitha seksionet përmbanin pyetje të mbyllura dhe të hapura, me synimin për të mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore.

Intervista gjysmë e strukturuar përmbante një listë me 21 pyetje të hapura që ishin krijuar për të mbledhur informacion të thelluar në lidhje me praninë e ALF-së në Shqipëri, rolin e DiR në koordinimin e rrjetit, rolin e anëtarëve të rrjetit në aktivizimi i rrjetit dhe promovimin e DN, përdorimi i qendrës burimore DN dhe partneritetet Euro-Med.

Krahas të dhënave parësore të mbledhura nëpërmjet këtyre instrumenteve, të dhënat dytësore u mblodhën nëpërmjet faqes së internetit të ALF-së, rishikimeve dhe raporteve. Këto të dhëna dytësore përbëjnë një të dhënë kryesore për raportin.

3.4 Procesi i mbledhjes së të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave dytësore dhe parësore ka qenë një sfidë duke marrë parasysh kohën e kufizuar në dispozicion. Të dhënat janë mbledhur nga data 18 shkurt deri më 12 mars. Shkurtimisht, procesi ishte si më poshtë:

18 shkurt - 28 shkurt 2022: Mbledhja dhe shqyrtimi i dokumenteve përkatëse. Studiuesit kryen një rishikim literature të burimeve dytësore që ishin vënë në dispozicion nga Sekretariati i Fondacionit Anna Lindh; ishin të disponueshme në faqen e internetit, ose që ishin të disponueshme nga burime të tjera.

18 shkurt - 28 shkurt: shpërndarja dhe plotësimi i pyetësorit nga 30 anëtarë të Rrjetit Shqiptar. Anëtarët duhej të kontaktoheshin disa herë përmes platformave të ndryshme për të plotësuar pyetësin.

